



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 784/9 Prot

Tiranë, më 16/10/2015

V E N D I M

Nr. 45, datë 16/10/2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" (i ndryshuar), si dhe neneve 80-104 të Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", të procesverbalit të kontrollit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Bar Dubai*" Tiranë,

V Ë R E J S E

Në zbatim të Urdhrit nr. 174 datë 07/09/2015, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit e Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit, "*Bar Dubai*", regjistruar në Q.K.R. me emër subjekti Enrik Skënderi dhe NIPT L21702009D, me objekt:

- Plotësimi nga ana e kontrolluesit të detyrimit për informim (neni 18) të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" (i ndryshuar), dhe Udhëzimin nr. 3, datë 05/03/2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*" (i ndryshuar).
- Plotësimi nga ana e kontrolluesit të detyrimit për njoftim (nenet 21, 22) të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale pas shqyrtimit të procesverbalit të kontrollit administrativ dhe provave të administruara konstaton se:

1. Nga kontrolluesi "*Bar Dubai*" është shkelur neni 21 i Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" (i ndryshuar), sipas të cilit:

"1-Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë."

Kontrolluesi "*Bar Dubai*", nuk ka njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit, në kohën e duhur për grumbullimin, mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave "*imazhe*" të subjekteve të të dhënave personale, njoftim i cili është një detyrim shumë i rëndësishëm në drejtëm të respektimit të privatësisë dhe përpunimit të ligjshëm të të dhënave të subjekteve (klientë).

Për shkeljen e konstatuar është mbajtur procesverbali i kontrollit administrativ, datë 18/09/2015, si dhe në zbatim të neneve 93-96 të Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", më datë 07 dhe 14/10/2015 janë organizuar seancat dëgjimore, ku janë njoftuar për tu paraqitur përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të kontrollit administrativ. Në të dy këto seanca dëgjimore, kontrolluesi nuk është paraqitur, ndonëse për seancën e datës 14/10/2015 është konfirmimi zyrtar për njoftimin e tij.

Si përfundim, konkludoj se shkelja e konstatuar gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" (i ndryshuar), përbën "**kundërvajtje administrative**" dhe sanksionohet me gjobë.

- Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkelja e konstatuar është serioze, pasi lidhet, me sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, me detyrimet që i dalin kontrolluesit nga zbatueshmëria e Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" (i ndryshuar), neni 39/1, në të cilin parashikohet se: "*Rastet e përpunimit të të dhënave në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kur nuk përbëjnë kundërvajtje penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë..etj*".

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 29, 30, 32, 39/1, paragrafi "d", të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" (i ndryshuar), si dhe nenet 107-109 të Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë":

V E N D O S A

1. Dënimin e kontrolluesit "Bar Dubai", me gjobë në vlerën 20.000 (njëzet mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në **nenin 21** të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" (i ndryshuar).
2. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e njoftimit, sipas nenit 40 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" (i ndryshuar) dhe nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Ky Vendim u shpall sot më 16/10/2015.

